



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal

Nr 2, datë 31.01.2023

I mbledhjes së këshillit të bashkisë, e cila zhvillohet në sallën e mbledhjeve në Pallatin e Kulturës “Labëria”(Ora 10¹⁰)


Marrin pjesë :

- | | |
|---------------------|----------------------|
| 1.Jonela Halili | 16.Eravis Moçka |
| 2.Sulltana Bilbilaj | 17.Liljana Breshani |
| 3.Bujar Osmanaj | 18.Englantina Imeraj |
| 4.Adiola Gjoka | 19.Ardian Skëndaj |
| 5.Ina Islamaj | 20.Kreshnik Tepelena |
| 6.Simo Petromilo | 21.Jerina Dervishaj |
| 7.Migena Balla | 22.Edlira Kapllanaj |
| 8.Brunilda Cani | 23.Grigor Dede |
| 9.Rozina Kormuzi | 24.Julian Bleta |
| 10.Ramona Jaho | 25.Klearda Rapushi |
| 11.Edison Kapaj | 26.Evis Allushi |
| 12.Arben Meksi | 27.Sokol Kushta |
| 13.Kasëm Mahmuti | 28.Istref Dobi |
| 14.Anisa Shametaj | 29.Pëllumb Nezha |
| 15.Teki Xhemalaj | 30.Fatos Rukaj |

Mungojnë:

- 1.Alboren Aliaj
- 2.Brunilda Saliaj
- 3.Briseida Çakërri

- 4.Frosina Qyrdeti
- 5.Lindrit Beqiraj
- 6.Asime Feraj
- 7.Klara Bajaziti
- 8.Elona Toçaj
- 9.Sulejmën Bubeqi
- 10.Roneda Muçaj
- 11.Andi Resulaj
- 12.Kristaq Meçi
- 13.Rudi Pashaj
- 14.Paula Sullaj
- 15.Besian Gega
- 16.Anxhela Aliraj
- 17.Ervis Caushaj
- 18.Gentian Hamzaraj
- 19.Mujo Shakaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 2/1, datë 31.01.2023

Znj.Migena Balla – Fillojmë mbledhjen. Para se të kalojmë në rendin e ditës, fjalën e ka zonja Jonela, për të na njohur me shprehjen e ligjshmërisë.

Znj.Jonela Halili – Me shkresat e ardhura nga institucioni i prefektit të qarkut Vlorë, për vendimet e këshillit për mbledhjet e kaluara , Nr 95 datë 23.12.2022 dhe Nr 96,97,98,99 datë 30.12.2022, janë shprehur të ligjshëm si dhe, me shkresën për mbledhjen e datës 18 janar 2023, Vendimin Nr 1 datë 18.01.2023, janë shprehur të ligjshëm , nga institucioni i prefektit të qarkut Vlorë.

Z.Ardian Skëndaj - Do të kërkoja saktësim, nga kryetari, anëtari i komisionit të financës...

Znj.Migena Balla – Sot në rednin e ditës kemi 7 pika. I keni dhe në adresë elektronike. Keni gjë për rendin e ditës ?

Votohet.

Pro – të gjithë.

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Miratohet rendi i ditës.

Vahdojmë me rendin e ditës.

Kalojmë në pikën 1, të rendit të ditës, në miratimin e procesverbalit të mbledhjes së këshillit të bashkisë , datë 23.12.2022 dhe, datë 30.12.2022.

Edhe këtë material e keni patur.

Keni gjë ?

Votohet.

Pro – 30 vota.

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 2/2, datë 31.01.2023.

Znj.Migena Balla – Kalojmë në pikën 2 të rendit të ditës, në miratimin e projektvendimit
“ Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e bashkisë për muajin dhjetor 2022”.
Një relacion nga zonja Irena ?

Znj.Irena Stasa – Në këtë projektvendim , dalë nga sistemi i pikëzimit , me të ardhurat e bashkisë, janë 41 familje përfituese , së bashku rajone dhe njësi administrative.
Si dhe, të mos trajtohen 2 familje dhe, të trajtohen 2 familje që hyjnë për herë të parë në skemën e ndihmës , sipas arsyeve përkatëse.

Znj.Migena Balla – Pyetje, diskutime ?

-Jo.

E hedhim në votë. Votohet.

Pro – 30 vota.

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 2/3, datë 31.01.2023.

Znj.Migena Balla - Kalojmë në pikën 3 të rendit të ditës, në miratimin e projektvendimit
“ Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin dhjetor 2022”.

Znj.Irena Stasa – Janë 16 familje që përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar, me fonde të qeverisë.

Z.Simo Petromilo – Ka ndonjë prioritet për rritjen e numrit të këtyre familjeve nga qeveria , për ndihmë për këto familje ?

Znj.Irena Stasa - Nuk ka një fond të përcaktuar saktë, jo fond i madh .Të tjerat i trajtojmë me të ardhurat e bashkisë.

Znj.Migena Balla – Pyetje, diskutim tjetër ?

-Jo.


Votohet.

Pro – 30 vota.

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 2/4, datë 31.01.2023.

Znj.Migena Balla – Kalojmë në pikën 4 të rendit të ditës, në miratimin e projektvendimit “Për miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën, si dhe nga fondet e buxhetit vendor “.

Një relacion?

Znj.Irena Stasa – Këto 2 skema mbështetëse , që ne trajtojmë çdo muaj, përfituesit e tyre, duhet të kenë arsye dhe problematika të ndryshme si; vështirësi ekonomike sociale, duhet të jenë familje ekstremisht të varfëra, të dala nga sistemi i pikëzimit, familje me paaftësi , sëmundje të rënda, familje që nuk fitojnë në sistemin e pikëzimit. Këto janë disa nga kriteret bazë për përfitimin e ndihmës ekonomike.

Znj.Migena Balla – Pyetje, diskutime ?

-Jo.

E hedhim në votë.

Pro -30 vota.

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 2/5, datë 31.01.2023.

Znj.Migena Balla – Kalojmë në pikën 5 të rendit të ditës, në miratimin e projektvendimit “Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia e banesës së z.Gazmir Kuçaj në datën 21.10.2022 dhe, shpërblimin financiar nga ana e Bashkisë Vlorë “.

Një relacion nga administrata.

Z.Adrian Vreshtazi – Drejtorja e mbrojtjes civile vjen me një projektvendim për shpërblimin financiar nga djegia e banesës së zotit Gazmir Kuçaj , në lagjen “Partizani”.

Bazë për fillimin e procedurave është VKM Nr 329 , i cili fillon me kërkesën e qytetarit, vërtetim zjarri nga zjarrfikësja. Vazhdohet me drejtorinë e mbrojtjes civile me procesverbalet, çohet më pas në këshillin e qarkut për preventiv.

Znj.Migena Balla – Pyetje, diskutime ? - Jo.

E hedhim në votë.

Pro – 30 vota.

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0 vota.

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA V Lorë
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 2/6, datë 31.01.2023.

Znj.Migena Balla – Kalojmë në pikën 6 të rendit të ditës, në miratimin e projektvendimit “Për një ndryshim të VKB Nr 14, datë 24.02.2022 “Për caktimin e përfaqësuesve të Bashkisë Vlorë në bordet e institucioneve arsimore publike dhe jo publike “.

Relacion nga administrata.

Znj.Laura Brinja – Anëtarët në bord zgjidhen me vendim të këshillit bashkiak. Janë disa anëtarë që janë larguar , prandaj ju paraqesim këtë projektvendim për zëvendësimin e këtyre anëtarëve.

Znj.Migena Balla – Pyetje, diskutime ?

Z.Sokol Kushta – Bëmë mbledhjen e komisionit . Na vjen një relacion që ti votojë këshilli i bashkisë., kjo është gjysëm e gatëshme. Nuk informohemi sa herë mblidhen, si mblidhen. Unë di që mblidhen 3 herë në vit .

Znj.Migena Balla - Bordet janë të shkollave, ne nuk i detyrojmë dot.

Z.Ardian Skëndaj – Ka një rol, emri që futet.

Z.Sokol Kushta – Bashkia , përderisa ka anëtarë , ka lidhje. Cili është roli?, Kur mblidhen? Si mblidhen ? Janë formale ? Pse duhet të jenë formale. Ky bord përçon një frymë në bashki për këto shkolla.

Znj.Laura Brinja – Bordi është me mandat 3 - vjeçar. S’ka kritere për zgjedhjen e e anëtarëve. Bordi ka mësues, prindër, nga komuniteti dhe përfaqësues nga bashkia. Ka grafik dhe kalendar pune nga bordi dhe kërkohen nga bashkia përfaqësues , për problematika të ndryshme. Ne nuk kërkojmë procesverbalet. Shkollat sjellin tek ne kërkesat.

Znj.Migena Balla – Ka pyetje të tjera, diskutime ? –Jo.

Votohet.

Adresa:Sheshi "4 Heronjtë", www.vlora.gov.al; E-mail: info@vlora.gov.al


Pro – 30 vota.

Kundër – 0 vota.

Abstenim – 0.

Miratohet.

Adresa:Sheshi "4 Heronjtë", www.vlora.gov.al; E-mail: info@vlora.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA V Lorë
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 2/7, datë 31.01.2023.

Znj.Migena Balla – Kalojmë tek pika, Të ndryshme.

Znj.Edlira Kapllanaj – Dua të vë në dijeni komisionin për ndarjen e banesave sociale, në lidhje me komunitetin rom dhe egjiptian. Ju lutem, të shihen me përparësi..Të mos shkaktojmë pakënaqësi apo debate.

Znj.Liljana Breshani – Një grup banorësh nga njësia Shushicë, kërkojnë të marrin përgjigje në lidhje me lirim të varrezave në njësinë Shushicë . Është marrë një vendim në vitin 2016. Çfarë është bërë, për të liru tokën në varrezat e Llakatundit ?

Z.Birçe Aliraj – Në vitin 2016 nuk kam qenë...di që ka pas një vendim të këshillit bashkiak ...Për lirim të tokës në varrezat e Llakatundit, është në proces gjyqësor.,është dhënë tokë..

Znj.Migena Balla – Tjetër diskutim ?

Z.Simo Petromilo – Nga konstatimet dhe kërkesat e komunitetit , janë rënduar shumë rrugë të qytetit, ku sjellin prishje të rrugëve , të mjeteve. Rruga “Bektash Cakrani “ka qenë problematike, Ka pas aksione me financim të komunitetit dhe, kanali ngjitur me të ka probleme.

Përveç kësaj, di që ka dhe disa rrugë që kanë probleme, nga firmat që kanë mbaruar pallatet, kështu pranë shkollës “Drita e Dijes “. Mendoj që, bashkia duhet të marrë masa urgjente , të menjëherëshme , pasi shirat janë të pranishëm, është sezoni.

Znj.Erinolda Lushaj – Duhet investim. Ne i mbushim gropat, por pa kanalizime ,do të kthehen në atë gjendje.

Z.Pëllumb Nezha :

1. Problemi i ujit të pijshëm në lagjen e Pus Mezinit.
- 2.Mungojnë 2-3 shtylla elektrike.
- 3.Kanali i ujrave të larta, mbi ushtrinë, janë sistemuar në fillim, por në brendësi, në lagje, jo.
- 4.Pastrimi ,problem.
5. Ka ankesa për rrugë të bllokuar , është paraqit dhe në komisionin e peticioneve, kërkesave.
- 6.Mungojnë dritat, bazamentet e llampave.

Z. Teki Xhemalaj - Doja të diskutoja , në lidhje me funksionimin e linjës Vlorë – Orikum. Ka kaluar koha e domosdoshmërisë. Të dihen oraret, vijnë shumë për mësim dhe nevoja të tjera , të vihet urban, jo me mjete të tjera.

2. Qarkullimi i autobuzëve, të ketë emërtim dhe brenda në autobusë të shkruhet stacioni, ku ndalon. Ka dhe shumë të huaj në qytet, jo vetëm për qytetarët.

Z. Edison Kapaj – Dua një informacion në lidhje me Ujësjetësin e 15 fshatrave. Po punohet, nuk e dimë se në çfarë faze është Ujësjetësi i Novoselës.

2. Rruga Bestrovë-Bunavi, të gjithë e përdorin, por nuk e mirëmbajnë. Është e pakalueshme.

Znj. Migena Balla – Ka pyetje, diskutim tjetër ?

Z. Ardian Skëndaj – Vazhdojmë të kërkojmë prezencën e drejtorëve, të administratës në mbledhje. Mungojnë .Ka shumë probleme me ujësjetësin, shumë familje pa ujë. Si mund të bëhet mbledhje dhe nuk merret asnjë zgjidhje.

-Tek pallatet e Gorrishtit, s'ka shtylla .

-Në Bestrovë, s'ka kazanë.

Kush do të japë përgjigje për këto zonja kryetare ?

Znj. Migena Balla – Ju kuptoj.

Z. Ardian Skëndaj – Policia bashkiake, për heqjen e tabelave. Është jashtë funksionit çdo gjë.

-Tek "Lamanajt" kërkojnë ta bëjnë vetë investimin, s'ju vete njeri. Zonja kryetare përdor gjithë ...

Znj. Migena Balla – Drejtoresha nuk mundi të vinte. Ktheu përgjigje. Jam shumë koshiente.

Z. Ardian Skëndaj – Le të vijë një përfqësues tjetër.

Znj. Migena Balla – E kam përcjellë çfarë kërkoni ju.

Zonja Erinolda, në lidhje me shtyllat ...

Znj. Erinolda Lushaj -Në lidhje me "Lamanajt", nuk mund të prishet pallati..

Z. Ardian Skëndaj – Do ti shtrojë vetë qytetari. Nga mbledhja e kaluar, në lidhje me relacionin Unë kërkoj të bëhet një saktësim ...Kërkoj një përgjigje nga relatuesi.

-Si ...do të sqarohet marrdhënia juridike

-Pse e ke paraqitur ndryshe relacionin?

-Për çfarë dispozitash ligjore në fuqi, e ke fjalën për projektin e investimit ,faza e fundit....

Unë kam bërë një rezymë me çfarë u tha në komisionin juridik (Lexon)...për zgjidhjen e marrdhënieve juridike etj.....

Relatuesi nuk ka saktësuar asgjë, i ka lënë evazive.

Nga zgjidhje juridikeLigji Nr 8308 , është zbatuar ? (Bashkëlidhur relacioni)

Z. Grigor Dede – E para është sqaruar....zgjidhjen e marrdhënieve juridike, dhe të vazhdojë projekti , bazuar në legjislacionin në fuqi dhe PPVendor.

Znj. Migena Balla – Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Mbajti Procesverbalin

Zhaneta Gjika

Adresa: Sheshi "4 Heronjtë", www.vlora.gov.al; E-mail: info@vlora.gov.al